



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:047650

Datë: 10.05.2024

Numri i dokumentit: 05672112

KF.nr.394/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “CFI” Sh.P.K. me numër unik identifikues 811224708, me seli rr. “Dëshmorët e Kombit 641”, fshati Gurakoc, Komuna Klinë, të cilin me autorizim e përfaqëson Arbër Fazliu, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, duke vepruar sipas padisë së paditësit për anulim vendimi, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor të mbajtur me datë 08.05.2024, në prezencë të përfaqësuesit të palës paditëse Avokat Arbër Fazliu, e në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. Procedura gjyqësore në këtë konflikt administrativ **NDËRPRITET** për shkak të zgjidhjes së çështjes paraprake në procedurë penale.
- II. Procedura e ndërprerë do të vazhdoj pas nxjerrjes së vendimit të formës së prerë në procedurë penale.

A r s y e t i m

Paditësi, me padinë e datës 12.03.2021, ka iniciuar kontestin tregtar ndaj të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimin nr.495/2020,dhe kthimin e të njëjtit në rivendosje tek e paditura.

I autorizuari i paditësit në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 08.05.2024, ka deklaruar se mbesin në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë se paditësit. Më tej ka shtuar se e njofton gjykatën se për të njëjtën çështje për shkak te veprës penale shmangie nga tatimi, është duke u

zhvilluar procedure penale ndaj paditësit dhe pronarit V.F., andaj meqenëse kjo çështje është e lidhur me zgjidhjen e çështjes paraprake- penale nga gjykata Themelore ne Istog ne përputhje me nenin 32 te LKA-se dhe ne ndërlidhje me dispozitat e nenit 13 dhe 14 te LPK-ës, ka propozuar që kjo procedurë të ndërpritet derisa të zgjidhet çështja paraprake nga Gjykata Themelore ne Istog deri sa te kemi një vendim te plotfuqishëm. Gjykatës i dorëzoi procesverbalin e seancës se fundit te mbajtur ne Gjykatën Themelore ne Istog dhe një kopje te kallëzimit penal.

Gjykata në seancën gjyqësore pasi analizoj propozimin e të autorizuarit të paditësit dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 32 të LKA-së, vendosi ta ndërpresë procedurën e shqyrtimit gjyqësor në këtë konflikt administrativ, për shkak të çështjes paraprake deri në nxjerrjen e vendimit të formës së prerë në procedurën penale e cila aktualisht është duke u udhëhequr në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega Istog, ndaj të akuzuarit-pronarit të këtu paditësit. Sipas vlerësimit të gjykatës procedura penale ndaj pronarit të këtu paditësit ka filluar më herët dhe është në zhvillim e sipër dhe se çështja e cila është objekt i procedurës penale ndërlidhet direkt me çështjen e cila është objekt i shqyrtimit në këtë konflikt administrativ, andaj gjykata e vlerësoj të arsyeshme që të ndërpritet procedura gjyqësore, për shkak të çështjes paraprake në procedurë penale.

Nga të lartcekurat, gjykata konform nenit 81.C të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenit 32 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.394/22 datë 08.05.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.